



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 7337 Prot.

Fier, më 18.06.2025

PROJEKT VENDIM
Nr. 66, datë 18.06.2025

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Pandeli Nasto, lagjia "16 Prilli", Njësia Administrative nr.4, i dëmtuar nga zjarri i datës 28.05.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.139, datë 23.12.2024 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2025*" si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 28.05.2025, shkresës zyrtare nr.567/1.prot, datë 10.06.2025 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Pandeli Nasto dëmi në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është **253 000 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë** dhe në anën ndërtimore në vlerën **57 291 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë**, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja "gj", e ligjit 45/2019,

PROPOZON:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Pandeli Nasto, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **253 000 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë**.
2. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **28 645 (njëzetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës "ç" "Përcaktimi i ndihmës financiare" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale fianciare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Pandeli Nasto është në masën **281 645 (dyqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip **BANI**

Drejtoria Juridike
Esmeralda **KAPLLANAJ**

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera **ÇINA**

KRYETARI
Armando **SUBASHI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR

Vasil **BREGU**

